



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCËVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM
FINANCIAR PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT**

IEKA Instituti i Ekspertëve
Kontabël të Autorizuar

Nr. 426 Prot.

Data: 16/06/2024

Nr. 8354 Prot

Tiranë, më 12.6.2024

Lënda: Kërkesë për mendim mbi projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar””

INSTITUTIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Adresa: Rruga Elbasanit, Pallati EDIL-AL, Tiranë

Ministria e Financave, nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK), me mbështetjen e Bankës Botërore (BB), është angazhuar në përgatitjen e disa shtesave dhe ndryshimeve të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar”. Duke patur si qëllim kryesor përmirësimin e profesionit të audituesit ligjor si dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator të fushës së kontabilitetit dhe auditimit të vendit tonë me praktikën më të mira si dhe direktivat dhe rregulloret përkatëse të Bashkimit Evropian (BE), ndryshimet kryesore të ligjit synojnë të arrijnë këto objektiva:

- Përafrimin e legjislacionit me atë të BE, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin 6 të *acquis communautaire*;
- Përcaktim më të qartë të njësive që janë të detyruara të kryejnë auditimin ligjor;
- Forcimin e rregullave për kryerjen e auditimit ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NJEIP);
- Përcaktimi i detyrimit për dhënien e sigurtisë mbi raportimin e qëndrueshmërisë nga shoqëritë e auditimit;
- Qartësim më të madh dhe përmirësim të problematikave të evidentuara në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit aktual, me synim unifikimin dhe përmirësimin e zbatueshmërisë së këtij ligji.

Mbi sa më sipër, bashkëlidhur gjeni për mendim, projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar”, shoqëruar me relacionin shpjegues.

Lutemi dhënien e mendimit për një kohë sa më të shkurtër në mënyrë që të respektojmë afatet kohore të miratimit të tij.

Faleminderit për bashkëpunimin.

